

PROTOKOLLI KOMBËTAR I PRAKTIKËS KLINIKE PËR MENAXHIMIN E INFEKSIONEVE VIRALE TEK TE PORSALINDURIT (HIV, VRS, COVID, INFLUENCA, CMV)

Data e botimit: 2024

Data e rivlerësimit: *sipas nevojës*

Grupi i punës:

- Prof. Ermira Kola.....Shefe e Shërbimit të Reanimacionit Pediatrik - QSUT
- Prof. Asoc. Alketa Hoxha (Qosja).....Shefe e Shërbimit të Neonatologjisë
- Dr. Spiro Damo.....Neonatolog
- Dr. Gentiana Gora.....Neonatologe
- Dr. Evelina Kreko... ..Neonatologe
- Festime Sadikaj (Serjani)... ..Kryeinfermiere e Neonatologjisë, SUOGJ "Koço Gliozheni", Tiranë
- Eralda Mance Infermiere e Neonatologjisë, SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë", Tiranë
- Dr. Mirela Metaj... ..Neonatologe
- Ketrin Zeno... ..MSHMS
- Andoneta Njehrrrena MSHMS
- Prof. Gentjana Qirjako Shefe e Departamentit të Shëndetit Publik – UMT

Një falenderim për bashkëpunimin e specialistëve:

- Z. Ilir ShamataQKCSAISH
- Znj. Blerina Saraçi... .. Shërbimi i Imazherisë dhe Mjekësisë Nukleare
- Znj. Irena Korita.....Shërbimi i Labororit Klinik-Biokimik dhe Mikrobiologjik

Ky protokoll është përgatitur nga grupi i punës i ngritur nga MSHMS në Urdhërin me Nr. 390, datë 29.06.2022: "Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e Protokolleve mjekësore dhe infermierore për shërbimin e Neonatologjisë"

Ky dokument u hartua dhe publikua me mbështetjen teknike dhe financiare të zyrës së UNICEF në Shqipëri.

Përmbajtja në këtë botim është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNICEF në Shqipëri.

Përmbajtja e lëndës

Akronimet.....	5
Qëllimi.....	6
Infeksioni nga HIV-i.....	7
Kujdesi për foshnjën e infektuar nga transmetimi vertikal i virusit të HIV-it.....	12
Menaxhimi antiretroviral i të porsalindurve me ekspozim perinatal të HIV ose infeksion HIV.....	14
Menaxhimi antiretroviral neonatal sipas rrezikut të infektimit me HIV tek të porsalindurit.....	16
Terapia antiretrovirale.....	19
Ushqyerja e foshnjave të lindura nga nënat HIV-pozitive.....	20
Protokolli i trajtimit të fëmijëve me infeksion nga Virusi Respirator Sincicial (RSV).....	21
Vlerësimi dhe menaxhimi i foshnjave të konfirmuara pozitivisht për infeksion me COVID-19.....	27
Ushqyerja me qumësht gjiri.....	31
Ndikimi i pandemisë të SARS-CoV-2 në Kujdesin Neonatal.....	33
Transporti i të Porsalindurit dhe Pranimi në RTIN.....	35
Menaxhimi spitalor i neonatëve të lindur nga nëna të dyshuara apo të konfirmuara me COVID-19.....	36
Dalja nga Spitali i të Porsalindurit.....	37
Protokolli i menaxhimit të influenzës te i porsalinduri.....	40
Protokolli i menaxhimit të cCMV(Citomegalovirusi Kongenital).....	42
Diagnostikimi.....	45
Indikatore të monitorimit.....	52
Bibliografi.....	53

AKRONIMET

VLBW	Peshë shumë e vogël në lindje
RTIN.....	Reparti i terapisë intensive neonatale
OBSH... ..	Organizata botërore e shëndetësisë
AGA... ..	I përshtatshëm për moshën e barrës
SGA.....	I vogël për moshën e barrës
IUGR... ..	Prapambetje në rritjen intrauterine
MOM.....	Qumështi i vetë nënës së foshnjës
DMH	Qumështi nga nëna donatore
CMV.....	Citomegalovirus
RVS.....	Virusi respirator sincitial
HIV.....	Virusi i imunodeficiencës humane

Përdoruesit e Protokollit

Protokolli kombëtar i praktikës klinike për menaxhimin e infeksioneve virale tek te porsalindurit (*COVID-19, CMV, HIV, RVS, Influenca*) është hartuar të përdoret nga gjithë stafi shëndetësor (mjek dhe infermier) për të aplikuar dhe menaxhuar kujdesin për foshnjat me infeksione virale që trajtohen në RTIN në maternitetet bashkiake, maternitet e qarqeve dhe maternitetet terciare ku janë dhe dy repartet e terapisë intensive neonatale pranë SUOGJ "Mbretëresha Geraldinë" dhe SUOGJ "Koço Gliozheni" në Tiranë. Gjithashtu ky protokoll është përpiluar që të zbatohet edhe nga stafi shëndetësor që punon në konsultore si mjekët, infermierët e konsultorit dhe infermierët që kryejnë vizitat në shtëpi (0÷28ditë).

Gjithashtu u drejtohet të gjithë personave që kanë përgjegjësi për planifikimin, monitorimin dhe supervizimin e shërbimeve të kujdesit për të porsalindurin.

Popullata e përfshirë: Të porsalindurit me moshë 0 ÷ 28 ditësh, prindërit/ kujdestarët e foshnjës, përgjegjësit e reparteve të neonatologjisë pranë materniteteve bashkiake dhe të qarqeve dhe të shërbimeve terciare, drejtuesit e materniteteve dhe gjithashtu vendimmarrësit e të gjitha niveleve lidhur me kujdesin shëndetësor për fëmijën.

Qëllimi i Protokollit

Qëllimi i hartimit të këtij protokollit është që personeli të informohet në lidhje me për menaxhimin e infeksioneve virale tek te porsalindurit (*COVID-19, CMV, HIV, RVS, Influenca*) të foshnjave të shtrura në RTIN.

Gjithashtu duhet që të unifikohet qëndrimi i stafit të profesionistëve për për menaxhimin e infeksioneve virale tek te porsalindurit (*COVID-19, CMV, HIV, RVS, Influenca*) të foshnjave të shtrura në RTIN.

Infeksioni nga HIV-i

Pavarësisht progresit prej dekadash në uljen e shkallës së transmetimit vertikal (nga nëna te foshnja), fëmijët vazhdojnë të infektohen me HIV. Edhe me mbulimin e zgjeruar të trajtimit për gratë me HIV, transmetimi perinatal vazhdon të ndodhë tek foshnjat e lindura nga gratë e diagnostikuara me HIV në shtatzëni ose në lindje.

Foshnjat janë gjithashtu në rrezik të infektimit me HIV gjatë ushqyerjes me gji nga një lehonë pozitive për HIV. Përafërsisht gjysma e të gjithë fëmijëve të infektuar rishtazi marrin HIV gjatë ushqyerjes me gji.

Ndërhyrjet të cilat janë kryer duke filluar nga mesi i viteve 1990 si testimin universal të të gjitha shtatzanave për HIV, këshillimin, kontrollin e HIV-it në shtatzëni, trajtimin e shtatzënave me HIV nëpërmjet përdorimit të barnave antiretrovirale (ARV) për të parandaluar transmetimin perinatal (vertikal) (d.m.th., transmetimi gjatë shtatzënisë, lindjes) të HIV-it, lindje e planifikuar me SC për shtatzanat që kanë ARN të HIV >1000 kopje/mL afër lindjes, trajtimi i foshnjave me antiretrovirale dhe shmangia e ushqyerjes me gji kanë rezultuar në një ulje dramatike të shkallës së transmetimit perinatal të HIV-it.

Protokolli i OBSH-së të vitit 2016 konkludon se terapia me antiretrovirale duhet që të fillohet urgjent tek të gjitha shtatzanat apo tek nënat që ushqejnë foshnjën me gji edhe nëse ato kanë rezultuar pozitive në fund të shtatzanisë apo dhe gjatë periudhës së gjidhënies pasi rruga më efektive për të parandaluar transmetimin vertikal është që të reduktohet ngarkesa virale e nënës. Por më e mira është që të identifikohen shtatzanat që para apo në fillim të shtatzanisë në lidhje me statusin e HIV-it.

Foshnjat e lindura nga nëna me HIV që janë në rrezik të lartë për t'u prekur nga HIV duhet të marrin profilaksinë e dyfishtë me AZT dhe NVP ditore për gjashtë javët e para të jetës, pavarësisht nëse ushqehen me gji ose me qumësht formulë.

Udhërrëfyesi i OBSH-së i vitit 2021 theksoi se për të gjitha gratë shtatzëna, pavarësisht nga koha e fillimit të TAR, testimi i ngarkesës virale duhet të kryhet në javën 34÷36-të të shtatzënisë (ose dhe në lindje) për të identifikuar gratë që mund të jenë në rrezik të dështimit të trajtimit dhe/ose mund të lindin foshnja me rrezik më të lartë nga transmetimi perinatal.

Infant me risk të ulët janë ata që lindin nga:


1. nëna pozitive për HIV dhe që ka marrë terapi me antiretrovirale përgjatë gjithë shtatzanisë ose nga fillimi i tremestrit të parë ose fillimi i tremestrit të dytë.
2. Nese ngarkesa virale e nënës (e konfirmuar me analize) është < 50 kopje/ml ARN virale , afer fundit te shtatzanisë (4-6 jave nga fundi i shtatzanisë)

Infant me risk te larte jane ata qe:

1. Kane lindur nga nena te diagnostikuara pozitive me infeksion HIV, qe jane trajtuar per me pak se 4 jave nga lindja me terapi me antiretrovirale, ose

2. Kane lindur nga nena te diagnostikuara me infeksion HIV me nje ngarkese virale > 1000 kopje/mL e ekzaminuar rreth 4 jave perpara lindjes, nese ngarkesa virale eshte e percaktuar, ose
3. Kane lindur nga shtatzana ose nena qe ushqejne foshnjen ne gji q ekane marre infeksionin gjate periudhes se shtatzanise ose gjate ushqyerjes me gji, ose
4. Kane lindur nga nena qe jane diagnostikuar positive per here te pare ne periudhen gjate ose paslindjes, me ose pa test negative per HIV te kryer paralindjes

Algoritmi për vlerësimin e riskut në momentin e lindjes për të ndihmuar në identifikimin e foshnjave me risk të ulët ose të lartë



1. Asnjë manipulim:

- aplikimi i vitaminës K
- aplikimi i vaksinës ndaj hepatitit B
- marrja e analizave

të mos kryhen pa e larë më parë foshnjën e porsalindur

2. Të mos aplikohet vaksina e BCG-së (deri në konfirmim të negativitetit të analizës)

3. Të mos vendoset foshnja në gji (ose duhet të komunikohet me prindërit për riskun e infektimit të foshnjës dhe të vendoset së bashku me prindërit)

Për të parandaluar transmetimin vertikal të HIV është thelbësore të identifikohet nëse nëna është e infektuar ose jo. Edhe historia më e plotë dhe ekzaminimi fizik do të identifikojë më pak se gjysmën e grave pozitive. Prandaj, rekomandohet ofrimi i testeve për HIV në mënyrë rutinë për të gjitha gratë shtatzëna.

Terapia antiretrovirale për një grua të infektuar me HIV duhet të zgjidhet për të ofruar terapinë më të mirë për shëndetin e gruas, duke peshuar përfitimet dhe rreziqet e medikamenteve për fetusin. Përfitimi kryesor për fetusin është reduktimi i transmetimit të HIV dhe rreziku kryesor është toksiciteti i mundshëm i medikamenteve. Literatura mbi toksicitetin e agjentëve antiretroviralë në shtatzëni është e pakët. Përvoja më e madhe është me përdorimin e zidovudinës dhe deri më tani nuk janë vënë re efekte negative afatgjata. Për shkak të kompleksitetit dhe shpejtësisë së ndryshimit të informacionit mbi këto çështje, gratë shtatzëna HIV-pozitive kanë nevojë për këshillim për t'i ndihmuar ato të bëjnë zgjedhjet e tyre gjatë shtatzënisë.

Midis çifteve nënë-fëmijë që merrnin terapi antiretrovirale gjatë periudhës prenatale, intrapartum dhe neonatale, shkalla e transmetimit ishte 2.0% midis nënave që i janë nënshtruar lindjes me sectio cezariale elektive dhe 7.3% me mënyrat e tjera të lindjes.

Infeksioni kongjenital i HIV nuk është treguar të shkaktojë dismorfizëm. Nuk ka karakteristika klinike që dallojnë të infektuarit nga foshnjat jo të infektuara në lindje. Prandaj të gjithë foshnjat e ekspozuara ndaj HIV duhet të marrin profilaksinë për HIV që nga lindja. Rekomandohet trajtimi me zidovudinë në të tri periudha:

- prenatale,
- intrapartum dhe
- neonatale, por ka përfitime të mundshme edhe nëse jepet në një ose dy periudha.

Në situatat kur terapia e nënës për HIV ka qenë jo optimale, menaxhimi i HIV i foshnjës duhet të individualizohet, kështu që duhet kërkuar mendimi i një eksperti.

Zakonisht, foshnja duhet të marrë shurup Zidovudinë, në doze=2 mg/kg/doze për gjashtë javë.

Nëse foshnja është prematurë, mund të ketë nevojë të modifikohet doza.

Një nga efektet anësore më të zakonshme të profilaksisë së Zidovudinës është anemia, prandaj hemoglobina duhet të kontrollohet në lindje dhe në moshën 1 muajshe.

Të dhënat mjekësore të nënës duhet të rishikohen për agjentë të tjerë infektivë që mund të prekin foshnjën si:

- Hepatiti B dhe C,
- Herpes simplex,
- Citomegalovirusi,
- Toksoplazmoza,
- Sifilizi,
- Gonorrëa,
- Klamidia dhe
- Tuberkulozi.

Mjekët duhet të inkurajojnë dhënien e vaksinës së hepatitit B për të gjithë foshnjat e nënave të infektuara me HIV dhe nëse nëna është mbartëse e virusit të Hepatitit B, atëherë përveç kësaj duhet t'i aplikojnë foshnjës edhe imunoglobulinën.

Rekomandohet që një nënë HIV pozitive të mos ushqejë me gji për shkak të transmetimit të mundshëm të HIV-it përmes qumështit të gjirit.

Për shkak se të gjithë foshnjat do të kenë antitrupa HIV pozitiv për shkak të një transferimi pasiv të antitropave nga nëna e tyre, diagnoza e infeksionit duhet të konfirmohet duke testuar për antigjenin viral, sekuencat e ADN-së së HIV duke përdorur reaksionin zinxhir polimerazë (PCR) ose kulturën e HIV. Testimi i ngarkesës virale përdor testimin PCR, megjithatë, ky nuk është testi standard diagnostikues për HIV. Është hipotezuar se foshnjat që janë të infektuara peripartum nuk kanë një viremi të matshme deri disa ditë pas lindjes dhe se shumica e infeksioneve ndodhin peripartum. Prandaj, ndjeshmëria e testeve diagnostike të disponueshme për infeksionin perinatal HIV në 48 orët e para të jetës është më pak se 50%.

Gjaku i kordonit nuk duhet të përdoret për të testuar statusin HIV të foshnjës për shkak të rrezikut të kontaminimit me gjakun e nënës. Me terapinë aktuale që zvogëlon në mënyrë dramatike shkallën e transmetimit nga nëna te fëmija, pothuajse të gjitha foshnjat e ndjekura duhet të humbasin antitropat e HIV të nënës dhe të rezultojnë negative nga të gjitha testimet.

Një nga qëllimet e kujdesit është të përcaktojë, në mënyrë sa më efikase dhe të sigurt që të jetë e mundur, cilat foshnje nuk janë të infektuara. Në një foshnjë të infektuar, ngarkesa virale rritet me shpejtësi gjatë javëve të para të jetës dhe në moshën 14 ditëshe, sensitiviteti i ADN PCR arrin 93%. Është treguar se dy mostra sekuenciale të testuara për HIV me PCR ose kulturë kanë një vlerë parashikuese negative prej më shumë se 90%. Sensitiviteti dhe specifikiteti i testeve virologjike në zbulimin e HIV-1 tek foshnjat e ekspozuara, nënat e të cilëve kanë marrë zidovudine është e ngjashme me atë të testeve në çiftet nënë-fëmijë të patrajuara. Sensitivitetet e ADN - PCR, ARN - PCR dhe kulturës qelizore janë përkatësisht 81.9%, 99.6% dhe 85.3% dhe specifikitetet janë përkatësisht

97.1%, 100% dhe 99.6%. Prandaj, nëse një foshnjë ka të gjitha testet negative të HIV me PCR ose kulturë në dy mostra, një në moshën 1 muajshe dhe një tjetër në moshën 2÷4 muajshe, ajo foshnjë ka shumë të ngjarë të mos infektohet. Për të konfirmuar dhe dokumentuar që një foshnjë nuk është e infektuar duhet të ndiqet deri në të paktën 18 muaj, kohë në të cilën ai/ajo nuk duhet të ketë asnjë gjetje fizike që sugjeron për infeksion të HIV dhe testi i antitropave të HIV duhet të rezultojë negativ.

Pneumonia *Pneumocystis carinii* (PCP) shfaqet më shpesh tek foshnjat me infeksion të HIV midis moshës 2 dhe 8 muajshe dhe ka një shkallë të lartë vdekshmërie. Profilaksia me Trimetoprim/Sulfametoksazol (TMP/SMX) rekomandohet për të gjithë foshnjat derisa të përcaktohet statusi i tyre i infeksionit. Nëse dihet se foshnja nuk është e infektuar, trajtimi me antibiotikë duhet të ndërpritet. Për foshnjat që janë konfirmuar se janë të infektuar, trajtimi me Trimetoprim/Sulfametoksazol duhet të përdoret siç rekomandohet.

Edhe pasi testet tregojnë se një foshnjë nuk është e infektuar, ai fëmijë duhet të ndiqet çdo vit për shkak të çështjeve psikosociale që mund të ndikojnë në shëndetin e një fëmije që jeton në një familje me anëtarë të tjerë të infektuar me HIV. Disa nga çështjet afatgjata për një fëmijë të prekur janë zbulimi i diagnozës së HIV-it të nënës së tyre dhe/ose anëtarëve të tjerë të familjes, sëmundja kronike dhe vdekja e një familjari. Prandaj është shumë e rëndësishme që pasi kalon mosha neonatologjike (0÷28 ditë) foshnja duhet patjetër të referohet dhe të ndiqet nga mjeku infeksionist në Shërbimin e Pediatriisë pranë QSUT "Nënë Tereza". Duhet të ofrohet referim për një ekip multidisciplinar që ofron shërbime mjekësore dhe jo vetëm për fëmijët, e konfirmuar ose jo, sepse ekipet multidisciplinare në programe të tilla kanë burimet për t'u marrë me kompleksitetin e problematikave mjekësore dhe çështjet psikosociale me të cilat përballen shumë prej këtyre familjeve.

Kujdesi për foshnjën e infektuar nga transmetimi vertikal i virusit të HIV

Për foshnjën e infektuar nga transmetimi vertikal	
Shtatzënia	– Siguroni kujdesin e duhur ndaj nënës duke përfshirë terapinë antiretrovirale – Ofroni shërbime këshillimi – Konsideroni lindjen me sectio cezarea si një metodë për të reduktuar transmetimin perinatal
Gjatë lindjes	– Jepni Zidovudine intravenoze 2 mg/kg/orë për orën e parë dhe më pas 1 mg/kg/orë. – Reduktoni monitorimin invaziv, siç janë elektrodën
Në lindje	– Ushqyerja me gji nuk rekomandohet

	– Filloni shurupin Zidovudinë 2 mg/kg/dozë, dy herë në ditë, për gjashtë javë – Inkurajimi i fillimit të një serie vaksinash kundër hepatitit B; nëse nëna është pozitive për antigenin sipërfaqësor të hepatitit B, jepni imunoglobulinën e hepatitit B dhe serinë e vaksinave, brenda 24 oreve të para pas lindjes. Nuk duhet të aplikohet vaksina e BCG. – Mund të merret parasysh shtimi i testit të acidit nukleik (NAT) në lindje në qasjet ekzistuese të testimit të diagnostikimit të hershëm të foshnjave për të identifikuar infeksionin HIV tek foshnjat e ekspozuara me HIV
Para daljes nga spitali	– Kryeni teste gjaku nëse është e nevojshme për indikacione të tjera (psh premature, PROM, etj.)
Në moshën 4 javë pas lindjes	– Konsultë e detyruar me pediatrën infeksionist

Meqenese vdekshmëria në vitin e parë të jetës është shumë e lartë në mesin e foshnjave të patrajuara që jetojnë me HIV, testimi i hershëm i HIV-it, marrja e menjëhershme e rezultateve dhe fillimi i shpejtë i trajtimit janë thelbësore.

Infeksioni me HIV tek foshnjat mund të konfirmohet përfundimisht vetëm me teste virologjike duke përdorur teknologjinë NAT. Kjo është për shkak se antitruapat anti-HIV të nënës transmetohen përmes placentës dhe mund të detektohen tek fëmija deri në 18 muaj, duke parandaluar përdorimin e testeve serologjike që diagnostikojnë infeksionin HIV.

Qasja në diagnostikimin e hershëm të foshnjave është përmirësuar ndjeshëm në vitet e fundit, por vetëm rreth 60% e të gjithë foshnjave të ekspozuara ndaj HIV u testuan nga i dyti muaji i moshës në 2020. Inovative janë qasje të tilla si përdorimi i analizave në pikën e kujdesit dhe shtimi i një NAT gjatë ose rreth lindjes mund të përmirësojë identifikimin e shpejtë dhe fillimin e trajtimit tek foshnjat.

Foshnjat që rezultojnë HIV pozitive që në lindje nëpërmjet analizës NAT ka të ngjarë që janë infektuar gjatë shtatzanisë do e shfaqin sëmundjen shpejt dhe, në mungesë të trajtimit, mund të bëjnë eksitus në muajt e parë të jetës. Foshnjat e infektuara gjatë ose rreth lindjes mund të mos kenë virus të zbulueshëm nga analiza NAT për disa ditë deri në disa javë sepse mund të ndikohet nga barnat ARV të marra nga nëna për profilaksinë pas lindjes, duke na dhënë rezultat negativ.

Menaxhimi antiretroviral i të porsalindurve me ekspozim perinatal të HIV ose infeksion HIV

Rekomandimet

- Të gjithë të porsalindurit që janë ekspozuar në mënyrë perinatale ndaj HIV duhet të marrin medikamente antiretrovirale (ARV) pas lindjes për të zvogëluar rrezikun e transmetimit perinatal të HIV.
- Terapia medikamentoze me antiretrovirale për të porsalindurit, të administruara në doza që janë të përshtatshme për moshën gestacionale të foshnjës, duhet të fillojnë sa më afër që të jetë e mundur me kohën e lindjes, mundësisht brenda 6 orëve nga lindja.
- Regjimi me medikamente antiretrovirale i një të porsalinduri duhet të përcaktohet bazuar në faktorët riskues të nënës dhe foshnjës që ndikojnë në rrezikun e transmetimit perinatal të HIV. Përdorimet e regjimeve të medikamenteve antiretrovirale tek të porsalindurit përfshijnë si më poshtë:
 - **Profilaksia me medikamente antiretrovirale:** Administrimi i një ose më shumë medikamenteve antiretrovirale tek një i porsalindur pa infeksion HIV të dokumentuar për të reduktuar rrezikun e marrjes së HIV perinatal.
 - **Terapia e supozuar e HIV:** Administrimi i një regjimi me tre medikamente antiretrovirale tek të porsalindurit që janë në rrezikun më të lartë të marrjes së HIV perinatal. Terapia e supozuar e HIV synon të jetë trajtim paraprak për një të porsalindur që më vonë dokumentohet se ka HIV, por shërben gjithashtu si profilaksë kundër marrjes së HIV.
 - **Terapia HIV:** Administrimi i një regjimi me tre medikamente antiretrovirale në doza trajtimi (i quajtur terapi antiretrovirale [ART]) tek të porsalindurit me infeksion të dokumentuar HIV.
- Për të porsalindurit me rrezik të ulët të marrjes së HIV perinatal, rekomandohet një regjim me medikamente antiretrovirale 2-javor zidovudine (ZDV) për profilaksinë nëse i porsalinduri është ≥ 37 javë shtatzënie dhe ka lindur nga një person me HIV i cili-
 - Aktualisht merr dhe ka kryer të paktën 10 javë rresht terapi antiretrovirale gjatë shtatzënisë;
 - Ka arritur dhe mbajtur supresimin viral (të përcaktuara si të paktën dy teste të njëpasnjëshme me HIV ARN < 50 kopje/mL të marra të paktën 4 javë) për pjesën e mbetur të shtatzënisë;
 - Ka një ngarkesë virale < 50 kopje/mL në ose pas 36 javësh;
 - Nuk ka pasur infeksion akut HIV gjatë shtatzënisë;
 - Ka raportuar aderim të mirë ndaj terapisë antiretrovirale dhe shqetësimet e aderimit nuk janë identifikuar.
- Fëmijët e lindur nga individë që nuk plotësojnë kriteret e mësipërme, por që kanë një ngarkesë virale < 50 kopje/mL në ose pas javës së 36-të të shtatzënisë duhet të marrin profilaksi me zidovudine për 4 deri në 6 javë.
- Të porsalindurit me rrezik të lartë të ekspozimit perinatal të HIV duhet të marrin terapi supozuese për HIV me regjim me 3 medikamente antiretrovirale të administruara që nga lindja për 2 deri në 6 javë; nëse kohëzgjatja e

regjimit me 3 medikamente është më e shkurtër se 6 javë, profilaksia me zidovudine duhet të vazhdohet vetëm, për të përfunduar gjithsej 6 javë të profilaksisë. Të porsalindurit me rrezik të lartë të marrjes së HIV përfshijnë ata të lindur nga njerëz me HIV të cilët-

- Nuk kanë marrë medikamente antiretrovirale para lindjes, ose
 - Kanë marrë vetëm medikamente antiretrovirale intrapartum, ose
 - Kanë marrë medikamente antiretrovirale para lindjes, por nuk kanë arritur sopresim viral (të përcaktuara si të paktën dy teste të njëpasnjëshme me nivel ARN të HIV <50 kopje/mL të marra të paktën 4 javë larg) brenda 4 javëve nga lindja, ose
 - Kanë infeksion primar ose akut me HIV gjatë shtatzënisë.
- Të gjithë foshnjat e parakohshme <37 javë të shtatzënisë që nuk janë në rrezik të lartë të ekspozimit perinatal të HIV duhet të marrin zidovudine për 4 deri në 6 javë.
 - Foshnjat e nënave që kanë infeksion primar ose akut HIV gjatë ushqyerjes me gji duhet të menaxhohen si foshnjat me rrezik të lartë të transmetimit perinatal me terapi të supozuar të HIV.
 - Përdorimi i medikamente antiretrovirale përveç Zidovudine, Lamivudine dhe Nevirapine nuk mund të rekomandohet për asnjë indikacion tek të porsalindurit prematurë (<37 javë gestacion) për shkak të mungesës së të dhënave të dozimit dhe sigurisë.
 - Nëse një individ paraqitet me status të panjohur HIV dhe ka një test pozitiv të përsheptuar të HIV gjatë lindjes ose menjëherë pas lindjes, foshnja duhet të fillojë terapinë e supozuar të HIV. Nëse testimi suplementar i nënës është negativ, regjimi antiretroviral i foshnjës duhet të ndërpritet.
 - Për të sapolindurit me infeksion HIV, duhet të fillohet terapia antiretrovirale.
 - Personat me HIV duhet të marrin këshillim të bazuar në prova me në qendër pacientin për të mbështetur vendimmarrjen e përbashkët për ushqimin e foshnjave.

Kompleksiteti i diagnozës së foshnjave tani po rritet për shkak të rritjes së konsiderueshme të "trajtimit të të gjitha rasteve" (duke përfshirë gratë shtatzëna dhe ato që ushqejnë fëmijën me gji), zbatimi i përmirësimit të profilaksisë pas lindjes, reduktimi i shkallës së transmetimit nga nëna të fëmija dhe rritja e kontributit relative të transmetimit pas lindjes. Diagnoza e foshnjës nuk mund të konsiderohet më kryesisht si një test i vetëm, pasi tani kërkon testime shtesë gjatë kohëzgjatjes së ekspozimit. Prandaj, do të nevojiten disa konsiderata kyçe shtesë për të forcuar kaskadën e testimit të foshnjave gjatë gjithë periudhës së ekspozimit. Kjo përfshin sigurimin që fillimi i ART-së të mos vonohet tek foshnjat që jetonin me HIV.

Koha optimale e testimit virologjik për të diagnostikuar infeksionin HIV tek foshnjat përcaktohet nga katër faktorë:

1. kur ka ndodhur infeksioni (prenatale, intrapartum ose pas lindjes apo gjatë ushqyerjes me gji);
2. ndjeshmërinë, specifikën dhe vlerat parashikuese të analizës që përdoret;
3. rreziku i vdekshmërisë sipas moshës dhe

4. mbajtja në kaskadën e testimit dhe trajtimit
Gjurmimi aktiv i foshnjave me rezultate negative NAT në lindje është thelbësor për të siguruar që ata të kthehen në moshën gjashtë javë për t'u rritur pasi rezultate fallco negative të NAT-it në lindje ndodhin sic e shpjeguar më lart.

Menaxhimi antiretroviral neonatal sipas rrezikut të infektimit me HIV tek të porsalindurit

Niveli i rrezikshmërisë së transmetimit të HIV perinatal	Përshkrimi	Menaxhimi antiretroviral neonatal
Rrezik i ulët për infeksionin perinatal HIV	Foshnjat ≥ 37 javë shtatzënie kur nëna: - Aktualisht po kryen dhe ka kryer të paktën 10 javë rresht terapi antiretrovirale gjatë shtatzënisë; - Ka arritur dhe ka mbajtur sopresimin viral (të përcaktuara si të paktën dy teste të njëpasnjëshme me nivele të ARN HIV <50 kopje/mL të marra të paktën 4 javë) për pjesën e mbetur të shtatzënisë; - Ka HIV ARN <50 kopje/mL në ose pas 36 javësh dhe brenda 4 javësh pas lindjes; - Nuk ka pasur infeksion akut HIV gjatë shtatzënisë; - Ka raportuar aderim të mirë ndaj terapisë antiretrovirale dhe shqetësimet e aderimit nuk janë identifikuar.	Profilaksi me zidovudine për 2 javë
	Foshnjat e lindura nga nëna që nuk i plotësojnë kriteret e mësipërme, por që kanë një ARN të HIV < 50 kopje/mL në ose pas javës së 36-të të shtatzënisë	Profilaksi me zidovudine për 4-6 javë
	Foshnjat e parakohshme (shtatzënia <37 javë) të cilët nuk janë në rrezik të lartë të marrjes perinatale të HIV	Profilaksi me zidovudine për 4-6 javë
	- Nënat që nuk kanë marrë medikamente antiretrovirale antepartum; - Nënat që kanë marrë vetëm medikamente antiretrovirale brenda lindjes;	Terapia e supozuar e HIV duke përdorur ose Zidovudine, 3TC dhe NVP (doza e trajtimit) ose

Rrezik i lartë për infeksionin perinatal HIV	- Nënat që kanë marrë medikamente antiretrovirale para lindjes, por nuk kanë pasur sopresim viral (të përcaktuara si të paktën dy teste të njëpasnjëshme me nivel të ARN së HIV <50 kopje/mL të marra të paktën 4 javë) brenda 4 javëve përpara lindjes; - Nënat me infeksion akut ose primar HIV gjatë shtatzënisë ose ushqyerjes me gji (në këtë rast, ushqyerja me gji duhet të ndërpritet menjëherë)	Zidovudine, 3TC dhe RAL të administruara së bashku që nga lindja për 2 deri në 6 javë; nëse kohëzgjatja e regjimit me 3 medikamente është më e shkurtër se 6 javë, Zidovudine duhet të vazhdohet vetëm, për të përfunduar gjithsej 6 javë profilaksi.
Ekspozimi i të porsalindurit ndaj HIV të supozuar	- Nënat me status HIV të pakonfirmuar që kanë të paktën një test HIV pozitiv gjatë lindjes ose pas lindjes; - Nënat, i porsalinduri i të cilave ka një test pozitiv të antitrapave HIV;	Menaxhimi antiretroviral siç përshkruhet më sipër për të porsalindurit me rrezik të lartë të marrjes së HIV perinatal. Medikamentet antiretrovirale për foshnjat duhet të ndërpritën menjëherë nëse testimi shtesë konfirmon se nëna nuk ka HIV.
I porsalinduri me HIV	Test virologjik pozitiv për të porsalindurin ndaj HIV	Regjim antiretroviral me tre medikamente duke përdorur doza trajtimi.

Profilaksia me Zidovudine rekomandohet për foshnjat e lindura nga nëna me mono-infeksion HIV-2. Nëse nëna ka infeksion HIV-1 dhe HIV-2, regjimi antiretroviral i foshnjës duhet të bazohet në përcaktimin e rrezikut të ulët ose të lartë të transmetimit të HIV-1. Për shkak se HIV-2 nuk është i ndjeshëm ndaj NVP, RAL duhet të merret parasysh për foshnjat me rrezik të lartë të marrjes së HIV-2 perinatale.

Kohëzgjatja optimale e terapisë së supozuar të HIV tek të porsalindurit që janë në rrezik të lartë për marrjen e HIV është e panjohur. Të porsalindurit që janë në rrezik të lartë për marrjen e HIV duhet të marrin komponentin Zidovudine të regjimit të supozuar të terapisë HIV me tre medikamente për 6 javë.

Dy antiretroviralët e tjerë (3TC dhe NVP ose 3TC plus RAL) mund të administrohen për 2 deri në 6 javë; kohëzgjatja e rekomanduar për trajtimin me tre antiretroviral ndryshon në varësi të rezultateve të HIV të foshnjës, ngarkesës virale të nënës në momentin e lindjes dhe faktorëve shtesë të rrezikut për transmetimin e

HIV, duke përfshirë ushqyerjen me gjë.

Këshillimi me një ekspert për HIV pediatrik rekomandohet kur zgjidhni një kohëzgjatje terapie sepse ky vendim duhet të bazohet në faktorët e rrezikut të rasteve specifike dhe në rezultatet e përkohshme të HIV të foshnjave.

Antiretrovirali tek foshnjat duhet të fillohet pa prituri për rezultatet e testimit konfirmues për HIV, duke pasur parasysh gjasat e ulëta të një HIV fals pozitiv. Megjithatë, ekzemplari për testimin konfirmues të HIV duhet të merret përpara fillimit të terapisë antiretrovirale.

Shënim: Medikamentet antiretrovirale duhet të fillojnë sa më afër që të jetë e mundur me kohën e lindjes, mundësisht brenda 6 orëve nga lindja.

Analizat e antitrapave HIV zbulojnë në mënyrë të besueshme antitrapat e HIV tek fëmijët, por nuk mund të dallojnë antitrapa të vazhdueshëm të HIV-it të nënës nga antitrapat e prodhuar nga fëmija.

Kohët e fundit, më shumë theks i është vënë gjenerimit të provave për fillimin e hershëm të ART tek të porsalindurit, me synimin për të eksploruar rolin e kohës së fillimit të ART në përmirësimin e rezultateve dhe kufizimi i rezervuarit viral. Për të sapolindurit, fillimi brenda jo me larg se rreth 6 ore pas lindjes rezulton në një kohë katërfish më të shpejtë për të shtypur ngarkesat virale në krahasim me fillimin ndërmjet tetë dhe 28 ditëve të jetës.

Si konkluzion rrugët më efektive për të parandaluar transmetimin perinatal të HIV janë:

1. Të fillohet sa më shpejt që të jetë e mundur terapia me ART që në fillim të shtatzanisë (ideale që përpara konceptimit) për të realizuar profilaksinë para-ekspozimit të foshnjës dhe për të arritur një reduktim të ngarkesës virale të nënës para lindjes sa më shpejt që të jetë e mundur
2. Të mbahet e reduktuar ngarkesa virale e nënës përgjatë gjithë shtatzanisë
3. Të aplikohet tek infanti profilaksia me ARV post ekspozim ose terapi për HIV pozitiv të supozuar duke u nisur nga faktorët rrezikues që e kanë favorizuar transmetimin e HIV-it me qëllim reduktimin e riskut për transmetim rreth lindjes.

Rekomandohet që të kryhet testi i NAT (acid nukelik test) që në lindje pasi konsiderohet i rëndësishëm për të identifikuar infeksionin nga HIV tek foshnjat që kanë qënë në risk. Saktësimi i testeve diagnostikuese u rivlerësua në vitin 2015 pasi u evidentuan vështirësitë e diagnostikimit intrapartum të infeksionit. Por edhe një analizë e vetme e NAT pas lindjes është njëlloj sikur të humbësh nga diagnostikimi kështuqë kjo duhet të konsiderohet si një shtesë dhe jo si një zëvendësues i analizave të tjera siç është testimi që duhet të kryhet në moshën 4-6 javëshe

Terapia antiretrovirale

Menaxhimi i trajtimit të HIV për foshnjat e lindura para kohe mbetet sfidues për shkak të mungesës së informacionit të duhur farmakokinetik, të sigurisë dhe të dozimit, si dhe të formulimeve të përshtatshme.

Këtu përfshihet edhe dozimi për profilaksinë pas lindjes për foshnjat e ekspozuara ndaj HIV.

• Formulimet shurup oral duhet të shmangen nëse është e mundur (përveç trajtimit neonatal dhe parandalimit neonatal). Megjithatë dozimi i të porsalindurve në përgjithësi kërkon përdorimin e formulimeve të lëngshme nga goja për administrimin e dozimit të saktë, rekomandohet kalimi në formën e dozimit oral të ngurtë sa më shpejt të jetë e mundur.

Dozimi i barnave në formë shurupi për foshnjat në moshë më pak se katër javë

Iraci	Përqendrimi i solucionit oral	2 - <3kg		3 - <4kg		4 - <5kg	
		AM	PM	AM	PM	AM	PM
AZT	10 mg/ml	1 ml	1 ml	1.5 ml	1.5 ml	2 ml	2 ml
ABC	20 mg/ml	0.4 ml	0.4 ml	0.5 ml	0.5 ml	0.6 ml	0.6 ml
NVP	10 mg/ml	1.5 ml	1.5 ml	2 ml	2 ml	3 ml	3 ml
3TC	10 mg/ml	0.5 ml	0.5 ml	0.8 ml	0.8 ml	1 ml	1 ml
LPV/r	80 mg/ 20 mg/ml	0.6 ml	0.6 ml	0.8 ml	0.8 ml	1 ml	1 ml
	Granula 40 mg/10 mg qeskë	-	-	2	2	2	2
RAL	10 mg/ml	<1 javë		0.4 ml (1 herë në ditë)		0.5 ml (1 herë në ditë)	
	(Granula orale: 100 mg/qeskë)	>1 javë		0.8 ml		1 ml	

- Për të kryer ndryshimet e dozës gjatë një periudhe të shkurtër kohore dhe për të minimizuar gjasat e gabimeve, të gjitha barnat ARV brenda RAL duhet të dozohen në bazë të peshës kur përfundon vlerësimi dhe të mbahen deri në një javë. Të dhënat farmakokinetike për foshnjat premature janë të disponueshme vetëm për AZT; ka të dhëna të limituara dhe pasiguri për dozimin e duhur për NVP, RAL dhe 3TC për foshnjat premature me peshën e ulët të lindjes. Përveç kësaj, solutioni LPV/r nuk duhet t'u jepet foshnjave premature derisa të kenë arritur moshën 42 javëshe, për shkak të rrezikut të efekteve të përdorimit.
- Mos përdorni solutionin LPV/r për foshnjat në moshë më të vogël se 2 javë. Peletat LPV/r nuk duhet të përdoren për foshnjat më të vogla se tre muaj. Nëse nuk ekziston një formulim tjetër, një bustinë 2 herë në ditë mund të merret në konsideratë për foshnjat me moshë më të madhe se dy javë që peshojnë 2-3 kg për të minimizuar rrezikun e toksicitetit të mundshëm nga mbidoza.
- Granulat RAL për suspension oral duhet të mbahen për të sapolindurit që peshojnë të paktën 2 kg dhe të administrohen 1 herë në ditë gjatë javës së parë të jetës dhe 2 herë në ditë më pas.]

Ushqyerja e foshnjave të lindura nga nënat HIV-pozitive

1. Këshillimi për ushqyerjen e foshnjës duhet të fillojë para konceptimit ose sa më herët që të jetë e mundur në shtatzëni; informacioni dhe planet për ushqyerjen e foshnjave duhet të rishikohen gjatë gjithë shtatzanisë dhe përsëri pas lindjes. Gjatë këshillimit prindërit duhet të informohen se:

- Zëvendësimi i ushqyerjes me formulë të përgatitur siç duhet ose qumësht dhuruesi të pasterizuar nga një bankë qumështi eliminon rrezikun e transmetimit të HIV pas lindjes tek foshnja.
- Reduktimi i ngarkesës virale tek shtatzana dhe mbajtja e niveleve të ulëta gjatë gjithë shtatzanisë përmes terapisë antiretrovirale (ART) dhe pas lindjes ul rrezikun e transmetimit gjatë ushqyerjes me gji në më pak se 1%, por jo zero.

2. Zëvendësimi i ushqyerjes me formulë ose qumësht dhuruesish të pasterizuar rekomandohet për të eliminuar rrezikun e transmetimit të HIV-it nëpërmjet ushqyerjes me gji, kur shtatzana ose lebona me HIV nuk janë në terapi me anti-retrovirale dhe/ose nuk kanë një ngarkesë virale të reduktuar gjatë shtatzënisë (të paktën gjatë tremujorit të tretë), si dhe në lindje.

3. Nënat HIV-pozitiv që janë në terapi me anti-retrovirale dhe që kanë ngarkesë virale të reduktuar dhe gati të padetektueshme dhe që zgjedhin të ushqejnë foshnjën me gji duhet të mbështeten në këtë vendim.

-Nënat HIV-pozitiv që zgjedhin të ushqejnë me qumësht formule foshnjën e tyre të porsalindur duhet të mbështeten në këtë vendim dhe të këshillohen për këtë lloj ushqyerje.

Protokolli i trajtimit të fëmijëve me infeksion nga Virusi Respirator Sincicial (RSV)

RSV është shkaktari më i shpeshtë i infeksioneve të traktit të poshtëm respirator dhe është përgjegjës për 2.3% të vdekjeve në moshën 0-28 ditë. Njerëzit janë burimi i vetëm i infeksionit.

Zakonisht transmetohet nëpërmjet kontaktit direkt ose të afërt me sekrecionet e kontaminuara ose objekteve të kontaminuara me spërklat e pështymës të një pacienti me RSV.

RSV mund të jetojë për 6 orë në ambient, 45 minuta në letër dhe për 30 minuta në duar. Infeksioni në personelin spitalor ndodh nëpërmjet inokulimit të spërklave në epitel me anë të kontaktit dorë-sy dhe dorë-hundë. Ka shpërndarje epidemike gjatë dimrit dhe fillimit të pranverës. Periudha e replikimit viral varion nga 3-8 ditë deri në 3-4 javë për neonatët, të imunokompromentuarit.

Virusi sincicial respirator çon në afërsisht 3,400,000 shtrime në spital dhe të paktën 66,000 vdekje çdo vit, ku 99% e këtyre vdekjeve ndodhin në vendet në zhvillim. Aktualisht, nuk ka asnjë trajtim apo vaksinë efektive dhe të sigurt për infeksionet RSV dhe infeksioni me këtë virus vazhdon të jetë një problem klinik në mbarë botën. Profilaksia me Palivizumab, i cili është një antitrop monoklonal neutralizues ndaj RSV dhe i administruar grupeve me rrezik të lartë gjatë sezoneve epidemike, është e vetmja metodë parandaluese.

Të dhënat klinike

Pjesa më e madhe e fëmijëve të infektuar me RSV paraqesin shenja të prekjes së rrugëve të sipërme të frymëmarrjes dhe 20-30% të rasteve paraqesin sëmundje të rrugëve të poshtme (bronkiolit, pneumoni). Shenjat e bronkiolitit fillojnë si rrufë, kollë dhe progresojnë në takipne, frymëmarrje si fishkëllimë, rale, tërheqje subkostale dhe interkostale, frymëmarrje me flegra. Infeksioni me RSV në javët e para të jetës, kryesisht në foshnjat e lindura premature mund të paraqitet me të dhëna të pakta pulmonare, por më shprehur me letargji, irritabilitet, vështirësi në ushqyerje. Faktorët që rrisin riskun për prekje të rënda nga RSV janë foshnjat premature, sidomos ato atë lindura para 29 javëve të shtatëzanisë me infeksione kronike, displazia bronko pulmonare, kardiopati kongjenitale sidomos ato të shoqëruara me hipertension pulmonar, imunodeficiencat e fituara dhe të lindura. Faktorë të tjerë risku janë neonatët me peshë të vogël të lindjes, lindjet binjake, duhanpirja gjatë shtatëzanisë, mosushqyerja me gji, ekspozimi në ambientet me duhan, ambientet e mbipopulluara.

Të dhëna laboratorike

Testet laboratorike nuk japin të dhëna të rëndësishme në diagnostikimin e RSV. Hemograma nuk është specifike, vihet re rritje e lehtë e PCR. Grafia e mushkërisë tregon për hiperajrim, infiltrime, atelektazë. Diagnoza e RSV duhet bërë nëpërmjet të dhënave klinike, anamnezës së detajuar, laboratorit dhe imazherisë në rastet e rënda me prekje të traktit të poshtëm respirator. Diagnoza e shpejtë e virusit duhet për të vendosur diagnozën përfundimtare në foshnjat e hospitalizuara me qëllim ndërprerjen e mjekimit empirik të antibiotikëve, për të parandaluar transmetimin nosokomial dhe kontrollin e infeksionit. Marrja e sekrecioneve të traktit respirator mund të bëhet nëpërmjet lavazhit nazal, tamponit nazofaringeal ose aspirimit trakeal në pacientët e intubuar. Lavazhi nazal dhe aspirimi nazofaringeal kanë sensitivitet më të lartë. Kampioni duhet marrë 3-4 ditë pas shfaqes së shenjave klinike. Kultura e qelizave virale është konsideruar si standarti i artë në të shkuarën, por sot jo sepse rezultatet vonojnë 3-7 ditë. Kultura e shpejtë qelizore mundëson diagnozën brenda 48 orëve. Ekzaminimi serologjik nuk është ndihmës sepse serokonversioni ndodh pas 2 javëve, antitrukat ndaj virusit nuk detektohen te të gjithë fëmijët me infeksion nga RSV.

Testi i shpejtë antigenik jep përgjigjen për 30 min dhe ka sensitivitet 80-95%. RT-PCR është e preferuar, por ka kosto të lartë dhe ka kufizim në përdorim.

Trajtimi

Trajtimi i foshnjave të hospitalizuara me bronkiolit kërkon:

- terapi suporti dhe duhet të përfshijë
 - hidratimin,
 - vlerësimin e statusit respirator,
 - aspirimin e sekrecioneve dhe
 - ventilimin mekanik në rast nevojë.

Agjentët alfa dhe beta adrenergjikë:

Nuk rekomandohen të përdoren pasi nuk është vënë re përmirësimi i oksigjenimit dhe i ditëqëndrimit në spital. Evidencat nuk mbështesin as përdorimin e epinefrinës në inhalacione.

Kortikoterapia:

Evidencat kanë treguar se kortikosteroidet nuk kanë ulur numrin e shtrimeve në spital dhe as përmirësuar ditëqëndrimin në spital. Nuk rekomandohet të përdoren në rastin e bronkiolitit.

Antibiotikët:

Nuk rekomandohet përdorimi i antibiotikëve në bronkiolite nga RSV. Antibiotiku rekomandohet vetëm në otitet e shkaktuara nga RSV me bombim të membranës.

Parandalimi i infeksioneve nga RSV

Palivizumab është imunoglobulinë monoklonale që përdoret për profilaksi në rastet me infeksion nga RSV. Administrohet intramuskulare me 15 mg/kg, 1 herë në muaj. Fëmijët që përfshihen në profilaksi duhet të marrin dozën e parë në sezonin e RSV dhe rekomandohen 5 doza. Palivizumab nuk është efektive në trajtimin e infeksionit nga RSV dhe nuk rekomandohet për trajtim.

Kriteret për profilaksi te foshnjat me risk të lartë

- Foshnjat prematurë me displazi bronkopulmonare


Profilaksia duhet të konsiderohet gjatë sezonit të RSV gjatë vitit të parë të jetës për bebet prematurë që zhvillojnë displazi bronkopulmonare, me moshë gestacionale <32 javë dhe kërkesë për oksigjen >21% gjatë 28 ditëve të para të jetës.

Administrimi i Palivizumabit rekomandohet gjatë Tetorit deri në Mars në hemisferën veriore dhe në pjesën më të madhe të SHBA-së. Koha optimale për administrimin e Palivizumabit është pak para fillimit të sezonit të RSV (p.sh., tetor-nëntor), ose brenda javës së parë të jetës së një foshnje nëse lind nga tetori deri në mars (idealisht gjatë qëndrimit në spital pas lindjes).

Në vitin e dytë të jetës rekomandohet profilaksia për fëmijët që plotësojnë kriteret e displazisë dhe që kërkojnë trajtim të vazhduar (kortikoterapi, terapi me diuretikë ose mbështetje me oksigjen).

Për fëmijët me displazi bronkopulmonare që nuk kanë nevojë për terapi me oksigjen nuk rekomandohet profilaksia.

Strategjitë e mundshme të imunizimit kundër RSV për foshnjat që hyjnë në sezonin e tyre të parë të RSV.



Foshnjat me sëmundje kongjenitale të lindura

- Fëmijët me kardiopati kongjenitale që përfitojnë nga imuno-profilaksia kanë sëmundje kardiake jo cianotike të cilët marrin mjekim për të parandaluar IKK dhe që kërkojnë ndërhyrje kirurgjikale.
- Fëmijët me sëmundje kongjenitale të lindura që nuk janë në risk për infeksion nga RSV dhe nuk kanë indikacion për profilaksi janë:
 - hemodinamikisht stabël (defekt septal atrial sekondar, defekt septal ventrikular të vogël, duktus arterioz të hapur, stenoze pulmonare, stenoze aortike e pakomplikuara, koarktacion i lehtë i aortës)
 - foshnjat me anomali të korrektuara nga kirurgjia
 - foshnjat me kardiomiopati të lehtë që nuk marrin mjekim
 - foshnjat në vitin e dytë të jetës
- Prematurët pa displazi bronkopulmonare ose sëmundje kardiake kongjenitale
- Profilaksia konsiderohet në foshnjat prematurë me moshë gestacionale >29 javë dhe janë më të vegjël se 12 muaj në fillimin e sezonit të RSV dhe foshnjat e lindura në sezonin e RSV më pak se 5 muajshe.
- Foshnjat prematurë klinikisht të shëndosha pa anomali të tjera shoqëruese nuk kryejnë profilaksi.
- Foshnjat me anomali pulmonare anatomike ose sëmundje neuromuskulare
Foshnjat me këto anomali të cilat prekin aftësinë për të pastruar nga sekrecionet rrugët e sipërme pulmonare janë në risk më të lartë për tu hospitalizuar ndaj përfitojnë nga imunoprofilaksia .
- Foshnjat me sindromën Down
Foshnjat me sindromën Down që kanë dhe sëmundje të tjera bashkëshoqëruese si kardiopati, anomali pulmonare ose prematuritetet përfitojnë nga imunoprofilaksia.
- Foshnjat me fibrozë cistike
Foshnjat e diagnostikuara me screening neonator për fibrozë cistike nuk përbëjnë indikacion për profilaksi.
Foshnjat me fibrozë cistike, por me të dhëna për sëmundje kardiake kongjenitale ose bronkodisplazi pulmonare me ose pa prekje të ushqyerjes përfshihen në profilaksi.

Masat parandaluese për foshnjat me risk të lartë

- ✓ Nuk duhet të ekspozohen në ambiente me duhanpirje
- ✓ Duhet stimuluar ushqyerja me gji sipas udhëzimeve të Shoqatës Amerikane të Pediatriisë
- ✓ Të evitohen ambientet e mbipopulluara dhe ti jepet rëndësi higjenes së duarve

Konsideratat në lidhje me antitruPAT monoklonal me veprim të gjatë dhe imunizimin e nënës si strategji parandaluese kundër RSV për të gjithë foshnjat që hyjnë në sezonin e tyre të parë të RSV.

E gjelbër = avantazh; E kuqe = disavantazh.

AntitruPAT njerëzor monoklonal me veprim të gjatë

Imunizimi i nënës

Tipet e antitruPAve

Monoklonalë: e gjithë popullata neutralizohet; vetëm 1 epitop njihet

Përgjigje poliklonale ndaj disa epitopeve; një fraksion e antitruPAve mund të mos neutralizohet

Forca e antitruPAve të transferuar drejt foshnjës

Konsistent, të fortë meqë sasia e antitruPAve të transferuar është e kontrolluar

Nuk është konsistente tek të gjitha foshnjat sepse varet tek periudha e imunizimit të nënës sipas gjendjes së saj pas lindjes dhe të shqetësimeve shoqëruese (HIV, malaria, etj)

Kohëzgjatja e mbrojtjes

Gjatë kohëzgjatjes së një sezoni të RSV (5 muaj)

E pritur të jetë më pak se 4 muaj

Koha e imunizimit

Fleksibël: foshnjat e lindura në sezonin e RSV (administrim në lindje), jashtë sezonit (administrimi në fillim të sezonit) dhe foshnjat premature do të jenë të mbrojtura

Jo fleksibël (në trimestrin e 3 të shtatzanisë): foshnjat e lindura jashtë sezonit të RSV dhe disa foshnja premature mund të jenë të pambrojtura

Efikasiteti kundër varianteve që evoluojnë antigenetiksht

Nuk ka qenë një problem sinjifikant në përdorimin e palivizumab: ka mundësi të shfaqjes të varianteve të paprekshëm nga antitruPAT – survejanca molekulare e vazhdueshme është kyçe në mbrojtjen e të gjitha foshnjave

E pritur të jetë më pak e ndikuar nga evoluimi i antigenëve meqë disa epitope neutralizuese mund të ndikohen nga përgjigja e antitruPAve monoklonalë

Pranueshmëria nga popullata

Udhëzime të përgjithshme për kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve për të sapolindurit

- Veproni me kujdes gjatë gjithë kohës dhe përdorni metoda të posaçme për mbrojtje nga transmetimi.
- Mbajeni nënën dhe foshnjën të ndarë vetëm nëse nëna ka TB rezistent ndaj medikamenteve të ndryshme.
- Konsultoni stafin e RTIN në lidhje me kujdesin ndaj infeksioneve të tjera të nënës
- Inkurajimi i ushqyerjes me gji (duke ndjekur rregullat e duhura, kapacitetin e stafit, mbështetjen).
- Menaxhoni shtrydhjen dhe ruajtjen e qumështit të gjirit me kujdes për parandalimin e infeksioneve.
- Menaxhoni përgatitjen e formulës.
- Triazhimi i vizitorëve dhe përjashtimi i atyre që shfaqin shenja infeksionesh - grip, infeksion respirator, diarre dhe infeksion lëkure.

Vlerësimi dhe menaxhimi i foshnjave me risk ose të konfirmuara pozitivisht për infeksion me COVID-19

Sëmundja e Coronavirusit 19 (COVID-19) është përkufizuar si sëmundje e shkaktuar nga një Coronavirus i ri që shkakton Sindromën Severe Respiratore Akute Coronavirus 2 (SARS-CoV-2) i cili u identifikua fillimisht mes një shpërthimi të sëmundjes respiratore të përhapur në Wuhan City, Hubei Province, China. Fillimisht u raportua në OBSH më **31 dhjetor 2019**.

Më **30 janar të vitit 2020**, OBSH-ja shpalli shpërthimin e COVID-19 si një emergjencë globale shëndetësore.

Më **11 Mars 2020**, OBSH shpalli COVID-19 një pandemi globale, përcaktimi i parë i saj i tillë që nga shpallja e gripit H1N1 një pandemi në 2009.


Sëmundja e shkaktuar nga SARS-CoV-2 u quajt COVID-19 nga OBSH, sinonim i rrjedhur nga "sëmundja koronavirus 2019." Emri u zgjodh për të shmangur stigmatizimin e origjinës së virusit për sa i përket popullsisë, gjeografisë ose shoqatave të kafshëve. Më **11 shkurt 2020**, Grupi i Studimit të Coronavirusit i Komitetit Ndërkombëtar për Taksonominë e Viruseve lëshoi një deklaratë ku njoftoi një përcaktim zyrtar për virusin e ri: Sindromi i rëndë respirator akut koronavirus 2 (SARS-CoV-2).

Pandemia aktuale e sëmundjes së koronavirusit 2019 (SARS-CoV-2) ka rezultuar të jetë urgjenca më e madhe dhe më e përhapur në të gjithë botën. Edhe pse sëmundja koronavirus i ri (Covid-19) sulmoi me këmbëngulje popullatën e rritur, planet e emergjencës prekën të gjitha fushat e mjekësisë në të gjithë botën. Në veçanti, shtatzanat, prindërit e të porsalindurve dhe foshnjat u infektuan me pasoja të rënda që kërkuar asistencë mjekësore.

Në fakt nuk u evidentua nëse gratë shtatzëna kishin një shans më të lartë për të marrë COVID-19 sesa publiku i gjerë, ose të kishin më shumë të ngjarë të kishin si rezultat sëmundje serioze. Gratë shtatzëna përjetojnë ndryshime në trupin e tyre që mund të rrisin rrezikun që ato të preken më shumë nga disa infeksione, viruse nga e njëjta familje si COVID-19, dhe infeksione të tjera virale të frymëmarrjes, siç është gripi dhe gratë kanë një rrezik më të lartë për të zhvilluar sëmundje të rënda. Gjithashtu akoma nuk dihet në këtë kohë nëse COVID-19 do të shkaktonte probleme gjatë shtatëzisë ose do të ndikojë në shëndetin e foshnjës pas lindjes.

Po kështu ende nuk e dihet nëse një grua shtatzënë me COVID-19 mund të kalojë virusin që shkakton COVID-19 tek fetusin ose foshnja e saj gjatë shtatëzisë ose lindjes. Asnjë foshnjë e lindur nga nënat me COVID-19 nuk kanë testuar pozitive për virusin COVID-19. Në këto raste, të cilat janë një numër i vogël, virusi nuk u gjet në mostrat e lëngut amniotik ose tek qumështi i gjirit.

Pra, është plotësisht e mundur që dikush me simptoma të frymëmarrjes të ketë gripin sezonal dhe jo COVID-19. Sido që të jetë, temperatura e lartë gjatë tremujorit të parë mund të rriti riskun për defekte të caktuara të lindjes ose janë shoqëruar me rezultate të tilla si pesha e ulët e lindjes dhe lindja e parakohshme.



Parandalimi i infeksioneve tek të sapolindurit duke përdorur kujdes të specializuar

- Me rritjen e nivelit të kujdesit, ulet dhe rreziku për infeksion.
- Kërkon aplikim më strikt dhe vigjilent të praktikave të RTIN sesa kujdesi për të gjithë të sapolindurit.
- Higjiena e duarve përpara dhe pas kontaktit me çdo foshnjë është e nevojshme.
- Nuk lejohet përdorimi i të njëjtave mjete midis foshnjave të ndryshme.
- Parandalimi i marrjes së infeksioneve nga ushqime, ajër, ujë të kontaminuara.
- Mbrojtja e foshnjave nga vizitorët dhe punonjësit e infektuar.
- Përdorimi i mjeteve mjekësore në mënyrën e duhur.
- Ndjekja strikte e teknikave aseptike.
- Të sapolindurit që përkujdesen në infermieri, RTIN apo në dhomën e rikthimeve janë të ekspozuar ndaj foshnjave të tjera dhe ndaj më shumë patogjenëve sesa në dhomat ku vendosen bashkë me mamatë e tyre.

- Punonjësit e shëndetit duhen të kenë eksperiencë në aplikimin e këtyre praktikave në të gjitha aspektet e punës gjatë gjithë kohës.
- Të sapolindurit që janë të sëmurë ose premature janë veçanërisht të prekshëm ndaj infeksioneve që merren nëpërmjet kontaktit me duar, pajisjeve të teknikave invasive dhe procedurave që kryhen në RTIN.
